



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 491/7 Prot.

Tiranë, më 27.10.2022

V E N D I M

Nr.130, Datë 27.10.2022

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË INSTITUCIONIN KOMISIONI I
PROKURIMIT PUBLIK DHE PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË
MBIKËQYRJES**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në institucionin Komisioni i Prokurimit Publik,

VËREJ SE:

Me Vendimin nr. 81 , datë 3.6.2022 “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Komisioni i Prokurimit Publik”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Komisioni i Prokurimit Publik.

Administrimi i shërbimit civil në subjektin e mbikëqyrur, si institucion i pavarur, bazohet në nenin 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ku është parashikuar në mënyrë të shprehur se, “fusha e veprimit të tij shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore”.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, të kryera prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 491/1 prot., datë 03.06.2022, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 491/2 prot., datë 03.06.2022, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Komisioni i Prokurimit Publik”*, i është njoftuar institucionit.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i punës ka hartuar projekt raportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 491/5 prot., datë 26.09.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Komisioni i Prokurimit Publik, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, duke i lënë një afat 5 ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i punës.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në këtë institucion, janë respektuar kërkesat e ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, por përgjatë gjithë periudhës së kontrolluar janë vërejtur edhe disa mangësi, të cilat janë vënë në dukje si konstatime në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të tilla si:

→ Procedurat e rekrutimit për të gjitha pozicionet e nivelit ekzekutiv, nga njësia përgjegjëse, janë realizuar si procedura individuale, duke mos e vlerësuar më parë mundësinë e rekrutimit në grup pozicionesh.

Në këto rrethana, nga njësia përgjegjëse e institucionit, duhet patur në vëmendje në të ardhmen që aty ku paraqitet mundësia, procedurat konkurruese të realizohen sipas parimeve të përcaktuara në legjislacionin për shërbimin civil, sipas grupeve të administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, me qëllim garantimin e një procesi përzgjedhës transparent, të drejtë dhe objektiv të nëpunësve civilë.

→ Për punonjësit në periudhë prove, konstatohet se nuk është caktuar nëpunësi civil më i vjetër nën kujdesin e të cilit duhet të jetë kjo kategori punonjësish dhe për pasojë mungon mendimi me shkrim i këtij nëpunësi në praktikën e konfirmimit të nëpunësit.

Në lidhje me këtë aspekt, në të ardhmen, njësia përgjegjëse, duhet të kujdeset që eprori direkt i nëpunësit, të caktojë punonjësin që do të mbikëqyrë nëpunësin në periudhë prove dhe para se të nxjerrë vendimin e arsyetuar të konfirmimit,

krahas vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën e provës dhe certifikatës së trajnimit të detyrueshëm pranë ASPA-s, duhet të administrojë edhe mendimin e nëpunësit më të vjetër, nën kujdesin e të cilit është vendosur nëpunësi civil në periudhë prove.

Më tej, eprori direkt, krahas vlerësimit me notë në çdo rubrikë të formularit të vlerësimit, duhet të plotësojë me komente dhe spjegime ndarjet përkatëse të këtij formulari.

Komisioneri vlerëson se mangësitë e konstatuara më sipër, nuk janë të një natyre që e cënon thelbin e procesit të konfirmimit, e për këtë arsye procedura do të vlerësohet si e realizuar, por, njësia përgjegjëse dhe eprorët direkt, duhet të tregojnë kujdes në vijimësi, që në të ardhmen, në praktikën e konfirmimit të nëpunësit në përfundim të periudhës së provës, të zbatojnë detyrimet ligjore dhe të mos lejojnë të tilla raste.

Plotësimi i këtyre detyrimeve nga eprori direkt, për punonjësit që janë në periudhë prove, do të ndiqet në vijimësi nga Komisioneri duke kryer verifikimin në institucion.

- Struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, për rastin e pezullimeve nga shërbimi civil, pjesërisht ka vepruar sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar dhe Vendimit nr.124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”*, duke mos shënuar afatin kohor të pezullimit.

Aktualisht, këto pezullime kanë përfunduar afatin e tyre, ndaj në të ardhmen, njësia përgjegjëse duhet të tregojë kujdes në hartimin e aktit të pezullimit, duke respektuar përcaktimet e neneve 55 dhe 56 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, si dhe Kreut I, *“Pezullimi”* dhe Kreut II, *“Përfundimi i periudhës së pezullimit”*, të Vendimit nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”*, duke respektuar të gjitha hapat që janë pasqyruar në përmbajtje të raportit në nënçështjen përkatëse.

- Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë, formalisht është kryer sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar, por fakti që 88 % e nëpunësve janë vlerësuar në nivelin 1, *“shumë mirë”*, që është niveli më i lartë i vlerësimit, si dhe mungesa e komenteve në të gjitha rubrikat cedon objektivitetin e procesit.

Në këtë rast, jemi përpara një procesi administrativ me mangësi në raport me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, pasi *Zyrtartari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues dhe Zyrtari Autorizues*, si dhe *njësia e burimeve njerëzore*, si

njësia përgjegjëse që mbikëqyr procesin e vlerësimit, nuk e kanë pëmbryllur plotësisht procesin, ashtu si është analizuar në përmbajtjen e raportit.

Për sa më sipër sjellim në vëmendje të zyrtarëve që marrin pjesë në procesin e vlerësimit (*zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues/autorizues*), si dhe njësia përgjegjëse që mbikëqyr procesin, të bëjnë përpjekje serioze për të shmangur vlerësimet subjektive, duke plotësuar hap pas hapi të gjitha kërkesat që përcakton dispozita ligjore e sipërcituar për vlerësimin.

Ky është një rast që do të ndiqet në vijimësi në të ardhmen nga Komisioneri duke kryer verifikimin në institucion, në momentin e përmbylljes së procesit të vlerësimit të rezultateve në punë për 6 mujorin e dytë të vitit 2022.

→ Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit, si njësia përgjegjëse për zbatimin e ligjit, me qëllim garantimin e ligjshmërisë në të gjitha procedurat, duhet të luajë rol aktiv dhe të aplikojë të gjitha mjetet procedurale që i njej ligji nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në rast të mospërmbushjes së detyrimeve nga personat përgjegjës për një proces administrativ të caktuar, që kryhet gjatë zbatimit të ligjit.

Sa parashtruam më sipër, paraqesin disa elementë paligjshmërie që janë konstatuar nga mbikëqyrja në këtë institucion, të cilat nisur nga natyra e tyre, nuk cenojnë thelbin e proceseve të realizuara.

Parregullsitë janë pasqyruar në raport, me qëllim që të sillen në vëmendjen e subjekteve që kanë detyrë të administrojnë shërbimin civil dhe të mos përsëriten në të ardhmen, e ndërkohë do të jenë në fokusin e kontrollit të Komisionerit në vazhdimësi, për të mos lejuar përsëritjen e tyre.

Subjekti i mbikëqyrur, është njohur me projekt raportin dhe nëpërmjet shkresës nr.2099/1 prot., datë 03.10.2022, e ka dërguar pranë Komisionerit të nënshkruar nga personat përgjegjës, pa vërejtje, duke u shprehur dakord me të gjitha gjetjet e grupit të punës të pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, konstatova se parregullsitë e konstatuara nuk janë të natyrës së shkeljeve ligjore që kërkojnë rregullime të posaçme. Vërejtjet e pasqyruara në këtë akt, janë të karakterit parimor që nuk e cenojnë në thelb ndonjë prej proceseve të evidentuara, e në këto kushte, procesi i mbikëqyrjes nuk do të shoqërohet me vendim paralajmërimi.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Komisioni i Prokurimit Publik, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi dhe të përfundoj procesin e mbikëqyrjes në këtë institucion.

Problematikat e evidentuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar, kanë të bëjnë me aspekte të përgjithshme të zbatimit të ligjit, e për këtë arsye, Komisioneri do të përmbyllë procesin pa vendim paralajmërues. Sqarimi me burimet njerëzore e më tej ndjekja e zbatimit të ligjit në proceset me natyrë të ngjashme që do të kryhen rishtas, do të jetë në vëmendjen e vazhdueshme të stafit të Komisionerit.

2. Për këtë vendim të njoftohet Komisioni i Prokurimit Publik, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha